



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:207588

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05655324

C.nr.1404/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Genc Hasani, në çështjen juridike të paditesit çështjen kontestimore të paditësit B. B. me adresë rr. "R. M." në V., të cilin e përfaqëson Av. Valdet Kadriu me seli në Vushtrri, kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës në Prishtinë, të cilën e përfaqëson N. R., baza juridike: Kompensim i diferencës së pagës, gjykata jashtë seance, me dt. **03.05.2024**, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.KORRIGJOHET aktgjykimi i kësaj gjykate C.nr.1404/2022 i datës 26.04.2024, ashtu që në Piken **I** të dispozitivit nënpika a) ne rreshtin e trete në vend të shumës 2.864.17€ (*dymijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër euro e shtatëmbëdhjetë cent*), duhet te jetë shuma 1468.80 € (*njëmijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tete euro e tetëdhjetë cent*).

II. Pjesa tjetër e këtij aktgjykimi mbetet e pandryshuar.

III. Ky aktvendim është pjesë përbërëse e aktgjykimit **C.nr.1404/2022 i datës 26.04.2024**.

A r s y e t i m

Gjykata, vërejtë se në aktgjykimin e lëshuar nga kjo gjykatë me numër C.nr.1404/2022 i datës 26.04.2024 është lëshuar një gabim teknik, ashtu që në vend të shumës 2.864.17€ (*dymijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër euro e shtatëmbëdhjetë cent*), duhet te jetë shuma 1468.80 € (*njëmijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tete euro e tetëdhjetë cent*), andaj, në kuptim të dispozitës së nenit 165 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, për të eliminuar këto gabime teknike, bënë korrigjimin e aktgjykimit si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.1404/2022 i datës 03.05.2024

Gjyqtari,
Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur mund të paraqesë kundërshtim në afat prej 3 (tre) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.